



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE



BULETINI I PRONËSISË INDUSTRIALE (Patenta)

Nr. 02/2020

Tiranë më, 21 Janar 2020

Kodet e përdorura në gazette.....	3
INID Codes used in gazette	
Kodet e shteteve.....	4
States codes	
Patenta të lëshuara.....	9
Granted Patents	
Certifikata të mbrojtjes shtesë të lëshuara.....	113
SPC	
Patenta të skaduara për mospagesën e ripërtëritjes.....	115
Lapsed patents	
Korrigjime (ndryshim emri).....	117
Corrections	

Kodet INID dhe minimumi i kërkuar për identifikimin e të dhënave bibliografike lidhur me:

Patentat.

- (11) Numri i patentës
- (21) Numri kombëtar i aplikimit
- (22) Data e depozitimit në Shqipëri
- (30) Prioriteti
- (54) Titulli i shpikjes
- (57) Pretendimet
- (71) Emri dhe adresa e aplikuesit
- (72) Emri/ Adresa e Shpikësit
- (73) Emri dhe adresa dhe pronarit të patentës
- (96) Numri dhe data ndërkombëtare e aplikimit
- (97) Numri dhe data Nderkombëtare e publikimit

Kodet e shteteve

Afghanistan / Afganistani	AF
Albania / Shqipëria	AL
Algeria / Algjeria	DZ
Angola / Anguila	AI
Antigua and Barbuda / Antigua dhe Barbud	AG
Argentina / Argjentina	AR
Aruba / Aruba	AW
Australia / Australia	AU
Austria / Austria	AT
Bahamas / Bahamas	BS
Bahrain / Bahrein	BH
Bangladesh / Bangladeshi	BD
Barbados / Barbados	BB
Belarus / Bjellorusia	BY
Belgium / Belgjika	BE
Belize / Belice	BZ
Benin / Benin	BJ
Bermuda / Bermuda	BM
Bhutan / Bhutan	BT
Bolivia / Bolivia	BO
Bosnia Herzegovina / Bosnja Hercegovina	BA
Botswana / Botsvana	BW
Bouvet Islands / Ishujt Buver	BV
Brazil / Brazili	BR
Brunei Darussalam/Brunei Darusalem	BN
Bulgaria / Bullgaria	BG
Burkina Faso / Burkina Faso	BF
Burma / Burma	MM
Burundi / Burundi	BI
Cambodia / Kamboxhia	KH
Cameroon / Kameruni	CM
Canada / Kanada	CA
Cape Verde / Kepi i Gjelbër	CV
Cayman Islands / Ishujt Kaiman	KY
Central African Republic / Republika e Afrikës Qendrore	CF
Chad/ Cadi	TD
Chile / Kili	CL
China / Kina	CN
Colombia / Kolumbia	CO
Comoros / Komoros	KM
Congo / Kongo	CG
Cook Islands / Ishujt Kuk	
Costa Rica / Kosta Rika	CR
Cote d'Ivoire / Bregu I Fildishte	CI
Croatia / Kroacia	HR
Cuba / Kuba	CU
Cyprus / Qipro	CY

Czech Republic / Republika Çeke	CZ
Denmark / Danimarka	DK
Djibouti / Xhibuti	DJ
Dominika / Domenika	DM
Dominican Republic / Republika Domenikane	DO
Ecuador / Ekuadori	EC
Egypt / Egjipti	EG
El Salvador / El Salvadori	SV
Equatorial Guinea / Guinea Ekuatoriale	GQ
Eritrea / Eritrea	ER
Estonia / Estonia	EE
Ethiopia / Etiopia	ET
Falkland Islans / Ishujt Malvine	FK
Fiji / Fixhi	FJ
Findland / Findland	FI
France / Franca	FR
Gabon / Gaboni	GA
Gambia / Gambia	GM
Georgia / Gjeorgjia	GE
Germany / Gjermania	DE
Ghana / Gana	GH
Giblartar / Gjibraltari	GI
Greece / Greqia	GR
Grenada / Granada	GD
Guatemala / Guatemala	GT
Guinea / Guinea	GN
Guinea Bissau / Guinea Bisao	GW
Guyana / Guajana	GY
Haiti / Haiti	HT
Honduras / Hondurasi	HN
Hong Kong / Hong Kongu	HK
Hungary / Hungaria	HU
Iceland / Islanda	IS
India / India	IN
Indonezia / Indonezia	ID
Iran / Irani	IR
Iraq / Iraku	IQ
Ireland / Irlanda	IE
Israel / Israeli	IL
Italy / Italia	IT
Jamaica / Xhamaika	JM
Japan / Japonia	JP
Jordan / Jordania	JO
Kazakhstan / Kazakistani	KZ
Kenya / Kenia	KE
Kiribati / Kiribati	KI
Korea / Korea	KR
Kyrgyzstan / Kirgistan	KG
Kwait / Kuvaiti	KW
Laos / Laosi	LA

Latvia / Letonia	LV
Lebanon / Libani	LB
Lesotho / Lesoto	LS
Liberia / Liberia	LR
Macau / Makau	MO
Madagascar / Madagaskari	MG
Malawi / Malavi	MW
Malaysia / Malaizia	MY
Maldives / Maldives	MV
Mali / Mali	ML
Malta / Malta	MT
Marshall Islands / Ishujt Marshall	MH
Mauritania / Mauritania	MR
Mauritius / Mauritius	MU
Mexico / Meksika	MX
Monaco / Monako	MC
Mongalia / Mongolia	MN
Montserrat / Montserrati	MS
Morocco / Maroku	MA
Mozambique / Mozambiku	MZ
Myanmar / Myanmar	MM
Namibia / Namibia	NA
Nauru / Nauru	NR
Nepal / Nepal	NP
Netherlands / Hollanda	NL
Netherlands Andilles /Antilet Hollandeze	AN
New Zealand / Zelanda e Re	NZ
Nicaragua / Nikaragua	NI
Niger / Nigeri	NE
Nigeria / Nigeria	NG
Norway / Norvegjia	NO
Oman / Omani	OM
Pakistan / Pakistani	PK
Palau / Palau	PW
Panama / Panamaja	PA
Papua New Guinea / Papua Guinea e Re	PG
Paraguay / Paraguai	PY
Peru / Peruja	PE
Philippines / Filipine	PH
Poland / Polonia	PL
Portugal / Portugalia	PT
Qatar / Katari	QA
Republik Of Moldova / Republika e Moldavise	MD
Romania / Rumania	RO
Russian Federation/Federata Ruse	RU
Rwanda / Ruanda	RW
Saint Helena / Shen Helena	SH
Saint Kitts and Nevis / Shen Kits dhe Nevis	KN
Saint Lucia / Shen Lucia	LC
Saint Vincent and the Grenadines / Shen Vinsenti dhe Grenadinet	VC

Samoa / Samoa	WS
San Marino / San Marino	SM
Sao Tome and Principe /Sao Tome dhe Principe	ST
Saudi Arabia / Arabia Saudite	SA
Senagal / Senegali	SN
Seychelles / Sejshellet	SC
Sierra Leone / Sierra Leone	SL
Singapore / Singapori	SG
Slovakia / Sllovakia	SK
Slovenia / Sllovenia	SI
Solomon Islans / Ishujt Solomone	SB
Somalia / Somalia	SO
South Africa / Afrika e Jugut	ZA
Spain / Spanja	ES
Sri Lanka / Sri Lanka	LK
Sudan / Sudani	SD
Suriname / Surinami	SR
Swaziland / Shvacilandi	SZ
Sweden / Suedia	SE
Switzerland / Zvicra	CH
Syria / Siria	SY
Taiwan / Taivani	TW
Thailand / Tailanda	TH
Togo / Togo	TG
Tonga / Tonga	TO
Trinidad and Tobago / Trinidad dhe Tobako	TT
Tinisia / Tunizia	TN
Turkey / Turqia	TR
Turkmenistan / Turkmenistani	TM
Turks and Caicis Islands / Ishujt Turk dhe Kaiko	TC
Tuvalu / Tuvalu	TV
Uganda / Uganda	UG
Ukraine / Ukraina	UA
United Arab Emirates /Emiratet e Bashkuara Arabe	AE
United Kingdom/ Mbreteria e Bashkuar	GB
United Republic of Tanzania / Republika e Bashkuar e Tanzanise	TZ
United States of America / Shtetet e Bashkuara te Amerikes	US
Uruguay / Uruguai	UY
Uzbekistan / Uzbekistani	UZ
Vanuatu / Vanuatu	VU
Vatican / Vatikani	VA
Venezuela / Venezuela	VE
Vietnam / Vietnami	VN
Virgin Islands / Ishujt Virxhin	VG
Yemen / Jemeni	YE
Yugoslavia / Jugosllavia	YU
Zaire / Zaireja	ZR
Zambia / Zambia	ZM
Zimbabwe / Zimbabve	ZW

PATENTA TË LËSHUARA

(11) **8788**

(97) EP2986325 / 26/06/2019

(96) 14854074.3 / 14/10/2014

(22) 04/09/2019

(21) AL/P/ 2019/626

(54) **METODAT PËR TRAJTIMIN E ÇRREGULLIMEVE TË CIKLIT UREA**

09/01/2020

(30) 201361890827 P 14/10/2013 US and 201462044168 P 29/08/2014 US

(71) Immedica Pharma AB

Norrstullsgatan 15, 113 29 Stockholm, SE

(72) SCHARSCHMIDT, Bruce (45 St. Francis Boulevard, San Francisco, CA 94127) ;MOKHTARANI, Masoud (725 Castle Rock Road, Walnut Creek, CA 94598)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(57)

1. Një metodë për përcaktimin e një doze efektive të gliceril tri-[4-fenilbutirat] për trajtimin e një çrregullimi të ciklit urea në një subjekt në moshën 6 deri në 17 vjeç në nevojë të tij që përfshin:

përlllogaritjen e zonës së sipërfaqes së trupit (BSA) për subjektin; dhe

krahasimin e BSA të një vlerë e kufirit të parapërcaktuar e cila është 1.3 m²,

ku doza efektive është një dozë e parë prej 7.3 deri në 8.79 g/m²/ditë nëse BSA është në ose sipër vlerës së kufirit të parapërcaktuar ose një dozë e dytë prej 9 deri në 9.9 g/m²/ditë nëse BSA është poshtë vlerës së kufirit të parapërcaktuar.

2. Metoda e pretendimit 1, ku doza e parë është 8 g/m²/ditë.

3. Metoda e pretendimit 1 ose pretendimit 2, ku doza e dytë është 9 deri në 9.5 g/m²/ditë.

4. Gliceril tri-[4-fenilbutirate] për përdorim në një metodë për trajtimin e një çrregullimi të ciklit urea (UCD) në një subjekt në moshën 6 deri në 17 vjeç në nevojë të tij, ku metoda përmban hapat e:

përlllogaritjes së zonës së sipërfaqes së trupit (BSA) për subjektin,

krahasimit të BSA të një vlerë e kufirit të parapërcaktuar e cila është 1.3 m², dhe

administrimit të një doze të parë prej 7.3 deri në 8.79 g/m²/ditë të gliceril tri-[4-fenilbutirate] nëse BSA është në ose sipër vlerës së kufirit të parapërcaktuar ose një dozë e dytë prej 9 deri në 9.9 g/m²/ditë të gliceril tri-[4-fenilbutirate] nëse BSA është poshtë vlerës së kufirit të parapërcaktuar.

5. Gliceril tri-[4-fenilbutirate] për përdorim në pretendimin 4, ku doza e parë është 8 g/m²/ditë.

6. Gliceril tri-[4-fenilbutirate] për përdorim në pretendimin 4 ose pretendimin 5, ku doza e dytë është 9 deri në 9.5 g/m²/ditë.

7. Metoda e ndonjë prej pretendimeve 1-3, ose gliceril tri-[4-fenilbutirate] për përdorim në ndonjë prej pretendimeve 4-6, ku subjekti nuk është trajtuar më parë me një proilaç PAA ose një tjetër ilaç për pastrimin e azotit, ku proilaçi PAA është zgjedhur nga grupi i përbërë prej gliceril tri-[4-fenilbutirate] dhe fenilbutirate ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e tij duke përfshirë fenilbutirate natriumi.

(11) **8767**

(97) EP3413868 / 14/08/2019

(96) 16809172.6 / 08/11/2016

(22) 16/10/2019

(21) AL/P/ 2019/729

(54) KOMPOZIMI OFTALMIK PËR PËRDORIM NË TRAJTIMIN E CRREGULLIMEVE TË SYRIT NË LIDHJE ME NDRYSHIMET E SIPËRFAQES KORNESE KONTAKTIVALE

26/12/2019

(30) UB20160543 08/02/2016 IT

(71) Sooft Italia S.p.A.

Contrada Molino, 17, 63833 Montegiorgio (FM), IT

(72) BIONDI, Marco (Via A. Gramsci 19, 63822 Porto San Giorgio (FM)); BIONDI, Piero (Via A. Gramsci 19, 63822 Porto San Giorgio (FM)); STAGNI, Edoardo (Via Gregorio VIII n. 58, 00165 Roma); STAGNI, Marcello (Via Mazzini n. 165, 63822 Porto San Giorgio (FM))

(74) Ardit Loloçi

Rr. "FORTUZIN", N0. 137, Tiranë

(57)

1. Kompozimi oftalmik që përmban shoqërimin e acidit laktonionik, ose një kripë të tyre, që varion ndërmjet 1% w/w dhe 5% w/w, dhe acid hialuronik, ose një kripë të tyre, që varion ndërmjet 0.01% w/w dhe 1.0%, dhe një ose më shumë transportues dhe ekzipient të pranueshëm farmaceutik.

2. Kompozimi oftalmik sipas pretendimit 1, ku sasia e acidit laktobionik, ose kripërat e saj, variojnë ndërmjet 3.5% w/w deri 4.5% w/w, dhe sasia e acidit hialuronik, ose kripërat e saj, variojnë ndërmjet 0.05% w/w dhe 0.5% w/w.

3. Kompozimi oftalmik sipas ndonjë nga pretendimet paraprijëse, ku acidi laktobionik, ose kripërat e saj, është e barabartë me 4% w/w, dhe acid hialuronik, ose kripërat e saj, është e barabartë me 0.15% w/w.

4. Kompozimi oftalmik sipas ndonjë nga pretendimet paraprijëse ku kripa është një kripë sodi.

5. Kompozimi oftalmik sipas ndonjë nga pretendimet paraprijëse të karakterizuar në atë që ajo është izotonik, me osmolitet ndërmjet 250 dhe 350 mOsm/Kg dhe që ka pH ndërmjet 7.0 dhe 7.4.

6. Kompozimi oftalmik sipas ndonjë nga pretendimet paraprijëse të karakterizuar në atë që ajo përmban më tej agjent stabilizues të solucionit, agjentëve lubrifikues, agjentëve hidratues, agjentëve zbutës, agjentëve mbrojtës dhe kelatues.

7. Kompozimi oftalmik sipas pretendimit 6 që përmban disodium EDTA dhe N-hidroksimetilglucinat.

8. Kompozimi oftalmik sipas ndonjë nga pretendimet paraprijëse që përmban më tej agjentë terapeutik shtesë, të zgjedhur nga grupi i: faktorëve rritës, agjentëve anti-inflamatorë, vitamina, fibronektin, kolagen dhe acideve amino.

9. Kompozimi oftalmik sipas ndonjë nga pretendimet paraprijëse në cdo form për aplikime lokale.

10. Kompozimi oftalmik sipas pretendimit 9 në formën e pikave të syrit, xhelit, pomadës, sprait.

11. Kompozim oftalmik sipas ndonjë nga pretendimet paraprijëse që ka formulimet vijuese:

Sodium Lactobionate	4.0% w/w
Sodium hyaluronate	0.15% w/w
Sodium dihidrogjen fosfat dihidrat	0.225% w/w
Disodium fosfat dihidrat	0.686% w/w

Disodium EDTA	0.100% w/w
Sodium Hidroksimetilglicinate	0.002% w/w
ujë i distiluar	q.s. deri 100 g

12. Kompozimi oftalmik sipas ndonjë nga pretendimet paraprijëse që ka formulimin vijues:

Sodium Lactobionate	4.0% w/w
Sodium hialuronate	0.15% w/w
Sodium dihidrogjen fosfate dihidrate	0.225% w/w
Disodium fosfate dihidrate	0.686% w/w
ujë i distiluar	q.s. deri 100 g.

13. Kompozimi oftalmik sipas pretendimeve 1 deri 12 për përdorim në trajtimin e cregullimeve të syrit karakterizuar nga gjëndja inflamatore, ndryshimet e shiritit të lotit, sindroma e tharjes së syrit, stresi oksidative, stresi në sipërfaqen okulare, plakja e syrit.

14. Kompozimi oftalmik sipas pretendimit 1 deri 12 për përdorim në shërimin e plagës të epithelium kornesw-konjunktivale.

(11) **8791**

(97) EP3341608 / 04/09/2019

(96) 16770101.0 / 24/08/2016

(22) 21/10/2019

(21) AL/P/ 2019/738

(54) **TURBINE E TUNELIT TE ERES, ME AKS HORIZONTAL TE ROTACIONIT TE ROTORIT**

09/01/2020

(30) 41366415 25/08/2015 PL

(71) Staszór, Roman

Ul. Jednosci Narodowej 8, 97-300 Piotrków Trybunalski, PL

(72) Staszór, Roman (Ul. Jednosci Narodowej 8, 97-300 Piotrków Trybunalski)

(74) Eno DODBIBA

RR."Naim FRASHERI" P.60/3, Shk.1, Ap.16, Tiranë

(57)

1. Një turbinë tuneli me erë me një bosht horizontal të rotacionit të rotorit, përfshin:

- një shpërndarës (1) në formën e një trupi rrotullues, paret i të cilit ka, në pjesën boshtore të tij, formën e një profili aeronautik konveks-konkav me një grykë (17) të dizajnuar për t'u drejtuar drejt ajrit që rrjedh dhe e cila mbështetet nga një set mbajtës i drejtimit të erës (6) të një boshti rrotullues vertikal në drekun e turbinave, dhe

- një rotor (2) me tehe (7) që rrotullohet në planin e një gryke (Rt) të shpërndarësit (1) dhe skajet e poshtme janë të lidhura me një nyjë (3) të montuara në mënyrë koaksiale me shpërndarësin (1) dhe që kanë një kontur në përputhje me një profil aerodinamik të dhomës së motorit (4) e cila është e lidhur me shirita (5) me shpërndarësin (1), i karakterizuar në atë që skajet e poshtme të teheve (7) janë vendosur larg nga sipërfaqja e nyjeve (3) për nga dimensionin i hendekut më të ulët (z2), ku dimensionin përcaktohet nga lartësia e konektorëve (8) të montuara në skajet e poshtme të teheve (7) dhe tek nyjat (3), dimensionet e hendekut të sipërm (z1) midis skajeve të sipërme të teheve (7) dhe sipërfaqes së grykës (Rt) dhe hendekut të poshtëm (z2) variojnë nga 0.5 në 15% të rrezes së grykës (Rt), mundësisht nga 3 deri në 8%.

2. Turbina sipas pretendimit 1, e karakterizuar në atë që hendeku i sipërm (z1) përcaktohet nga lartësia e konektorëve (8) të fiksuar në skajet e sipërme të teheve (7) dhe në unazën rrotulluese (9) e cila rrotullohet në një prerje periferike (10) të shpërndarësit (1) dhe sipërfaqja e brendshme e së cilës ka formën e grykës (Rt).
3. Turbina sipas pretendimit 1 ose 2, e karakterizuar në atë që raportet e dimensioneve të hendeqeve të sipërme (z1) dhe hendeqeve të poshtme (z2) në gjatësinë e akordeve përkatëse (c1, c2) në skajet e teheve (7) të profileve, kanë vlera që variojnë nga 0.20 në 2.5, mundësisht nga 0.6 në 1.2.
4. Turbina sipas pretendimit 1, e karakterizuar në atë që secila prej teheve (7) të jetë e montuar në nyjet (3) me anë të dy konektorëve (8) që kanë një seksion tërthor të rrumbullakët, dhe të cilat janë të fiksuara në një drejtim radial afër mbaresave të profileve të skajeve të poshtme të teheve (7).
5. Turbina sipas pretendimit 2, karakterizohet në atë që secila prej teheve (7) të jetë e montuar në unazën rrotulluese (9) dhe në nyjen (3) me anë të dy konektorëve (8) që kanë një seksion tërthor të rrumbullakët (d), të fiksuar në një drejtim radial afër mbaresave të profileve të skajeve të sipërme dhe skajeve të poshtme të teheve (7).
6. Turbina sipas pretendimit 1 ose 2, karakterizohet në atë që paret i anësor i dhomës së motorit (4) ka një formë të një reflektimi pasqyre të një seksioni të profilin të brendshëm të shpërndarësit (1), ku skajet e seksionit përcaktohen nga pikat e kryqëzimit të vijës së drejtë (Ii) paralele me boshtin e shpërndarjes (O-O) dhe nga ai i realizuar përmes pikës së përparme të pjesës së nxjerrë të grykës (17) të shpërndarësit (1) dhe pikës (Ih) të sipërfaqes së brendshme në pjesën e hapur të shpërndarësit (1).
7. Turbina sipas pretendimit 1 ose 2, e karakterizuar në atë që raporti i zonës së projeksionit boshtor të të gjitha teheve (7) në planin e grykës (Rt) deri te zona aktive e rrjedhjes nëpër grykë (Rt) ka një vlerë që varion nga 0.02 në 0.30, mundësisht nga 0.10 në 0.15.
8. Turbina sipas pretendimit 1 ose 2, e karakterizuar në atë që raporti i zonës së të çarës hyrëse (Ri) në zonën aktive të rrjedhjes nëpër grykë (Rt) ka një vlerë që varion nga 1.0 në 1.6, mundësisht nga 1.20 deri në 1.30.
9. Turbina sipas pretendimit 1 ose 2, e karakterizuar në atë që raporti i zonës së të çarës hyrëse (Ri) në zonën e të çarës në dalje (Ro) ka një vlerë që varion nga 0.5 deri në 0.9, mundësisht nga 0.65 në 0.75.
10. Turbina sipas pretendimit 1 ose 2, e karakterizuar në atë që raporti i gjatësisë (Ld) i shpërndarësit (1) në diametrin e grykës (Rt) ka një vlerë që varion nga 0.3 në 1.1, mundësisht nga 0.6 në 0.8.
11. Turbina sipas pretendimit 1 ose 2, e karakterizuar në atë që raporti i gjatësisë (Ld) të shpërndarësit (1) me diametrin e të çarës në dalje (Ro) ka një vlerë që varion nga 0.1 deri në 0.9, mundësisht nga 0.4 në 0.6, ndërsa gjatësia (Ld) e shpërndarësit (1) në lidhje me diametrin e të çarës në hyrje (Ri) ka një vlerë që varion nga 0.2 në 1.0, mundësisht nga 0.5 në 0.7.
12. Turbina sipas pretendimit 2, e karakterizuar në atë që prerja periferike (10) në shpërndarësin (1) është formuar nga një strukturë e rrumbullakët mbështetëse (11) e një seksioni tërthor të hapur në drejtim të bushtit të shpërndarësit (1) dhe i cili ka shtresa të montuara të përbëra (12, 13) që përcaktojnë profiling aeronautik të shpërndarësit (1) dhe modulit të poshtëm (14) të grupit mbajtës (6) të drejtimit të erës.

13. Turbina sipas pretendimit 1 ose 2, e karakterizuar në atë që ka një gjenerator elektrik (15) të ndërtuar në dhomën e motorit (4) dhe rotorin i së cilës është nxitur nga nyja (3) e rotorit (2).

14. Turbina sipas pretendimit 12, e karakterizuar në atë që ka një gjenerator rryme (16) të ndërtuar brenda strukturës mbështetëse (11), me magnetë fikse të montuara në perimetrin e jashtëm të unazës rrotulluese (9) dhe me mbështjellje induksioni të fiksuara në strukturën mbështetëse (11).

15. Turbina sipas pretendimit 1, 2 ose 14, e karakterizuar në atë që shpërndarësi (1), struktura e tij mbështetëse (11), veshjet (12,13) e profilin aeronautik, unaza rrotulluese (9) dhe elementet e gjeneratorit të rrymës (16) ndahen në seksione periferike me dimensionet maksimale që mundësojnë transportimin në kontenerët standart, pjesët që grumbullohen duke qenë të ndërlidhura me kapëse fiksuese (18) në formën e kërkuar të punës së turbinës.

(11) **8768**

(97) EP3240554 / 31/07/2019

(96) 16731640.5 / 15/06/2016

(22) 21/10/2019

(21) AL/P/ 2019/740

(54) **BLAUTIA STERCOSIS DHE WEXLERAE PËR TU PËRDORUR NË TRAJTIMIN E SËMUNDJEVE INFLAMATORE DHE AUTOIMUNE**

26/12/2019

(30) 201510466 15/06/2015 GB; 201520508 20/11/2015 GB and 201606810 19/04/2016 GB

(71) 4D Pharma Research Limited

Life Sciences Innovation Building Cornhill Road, Aberdeen, Aberdeenshire AB25 2ZS, GB

(72) MULDER, Imke (Life Sciences Innovation Building Cornhill Road, Aberdeen Aberdeenshire AB25 2ZS); GRANT, George (Life Sciences Innovation Building Cornhill Road, Aberdeen Aberdeenshire AB25 2ZS); PATTERSON, Angela Margaret (Norwich Medical School Faculty of Medicine and Health Sciences University of East Anglia, Norwich East Anglia NR4 7JT); MCCLUSKEY, Seanin (c/o 4D PHARMA PLC 3rd Floor 9 Bond Court, Leeds West Yorkshire LS1 2JZ); RAFTIS, Emma (c/o 4D PHARMA PLC 3rd Floor 9 Bond Court, Leeds West Yorkshire LS1 2JZ)

(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania LTD, Rr. Pjeter BOGDANI, P.20/4, Ap.7/5, Tirane, 100

(57)

1. Një përbërje që përmban një shtam bakterial të species *Blautia stercoris* ose *Blautia wexlerae*, për tu përdorur në një metodë për trajtimin ose parandalimin e një sëmundjeje inflamatore ose autoimune.

2. Përbërja për përdorimin e pretendimit 1, ku përbërja është për tu përdorur në një metodë për trajtimin ose parandalimin e një sëmundjeje ose gjendjeje të përzgjedhur nga grupi që konsiston në astmë, e tillë si astma alergjike ose astma neutrofilike; artriti, i tillë si artriti reumatoid, osteoartriti, artriti psoriatik, ose artriti idiopatik juvenil; skleroza e shumëfishtë; neuromieliti optik (sëmundja Devic); spondiliti ankilozant; spondiloartriti; psoriazis; eritematoza lupus sistemike; sëmundja e zorrëve inflamatore, e tillë si sëmundja Crohn ose koliti ulceroz; sëmundja celiake; sëmundja pulmonare obstruktive kronike (COPD); uveiti; skleriti; vaskuliti; sëmundja Behcet; ateroskleroza; dermatitis atopik; emfizema; periodontitis; riniti alergjik; dhe refuzimi i alograftit.

3. Përbërja për përdorimin e pretendimit 2; ku:

- (i) përbërja është për tu përdorur në një metodë për trajtimin ose parandalimin e astmës, e tillë si astma neutrofilike ose astma alergjike, dhe ku përbërja është për tu përdorur në një metodë për reduktimin e neutrofilisë ose eozinofilisë në trajtimin e astmës; ose ku
- (ii) përbërja është për tu përdorur në një metodë për trajtimin ose parandalimin e artritis reumatoid, dhe ku përbërja është për tu përdorur në një metodë për reduktimin e fryrjes së artikulacioneve në artritin reumatoid; ose ku
- (iii) përbërja është për tu përdorur në një metodë për trajtimin ose parandalimin e sklerozës së shumëfishtë, dhe përbërja është për tu përdorur në një metodë për reduktimin e shfaqjes së sëmundjes ose vështirësisë së sëmundjes; ose ku
- (iv) përbërja është për tu përdorur në një metodë për trajtimin ose parandalimin e uveitit, dhe

përbërja është për tu përdorur në një metodë për reduktimin ose parandalimin e dëmtimit të retinës në uveit.

4. Përbërja për përdorimin e secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku përbërja është për tu përdorur në një metodë për reduktimin e prodhimit të IL-17 ose reduktimin e diferencimit të qelizës Th17 në trajtimin ose parandalimin e sëmundjes inflamatore ose autoimune.

5. Përbërja për përdorimin e secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku përbërja është për tu përdorur tek një pacient me nivele IL-17 të larta ose numër të lartë të qelizave Th17.

6. Përbërja për përdorimin e secilit prej pretendimeve 1-5; ku (a) shtami bakterial ka një sekuencë 16s rARN që është të paktën 95%, 96%, 97%, 98%, 99%, 99.5% ose 99.9% identike me sekuencën 16s rARN të një shtami bakterial të *Blautia stercoris*; ose ku (b) shtami bakterial ka një sekuencë 16s rARN që është të paktën 95%, 96%, 97%, 98%, 99%, 99.5% ose 99.9% identike me SEQ ID NO:1 ose 2; ku sipas (b), preferueshëm shtami bakterial ka një sekuencë 16s rARN që është të paktën 95%, 96%, 97%, 98%, 99%, 99.5% ose 99.9% identike me SEQ ID NO: 2, ose shtami bakterial ka sekuencën 16s rARN të përfaqësuar nga SEQ ID NO:2.

7. Përbërja për përdorimin e secilit prej pretendimeve 1-5; ku (a) shtami bakterial ka një sekuencë 16s rARN që është të paktën 95%, 96%, 97%, 98%, 99%, 99.5% ose 99.9% identike me sekuencën 16s rARN të shtami bakterial të *Blautia wexlerae*; ose ku (b) shtami bakterial ka një sekuencë 16s rARN që është të paktën 95%, 96%, 97%, 98%, 99%, 99.5% ose 99.9% identike me SEQ ID NO:3 ose 4; ku sipas (b), preferueshëm shtami bakterial ka një sekuencë 16s rARN që është të paktën 95%, 96%, 97%, 98%, 99%, 99.5% ose 99.9% identike me SEQ ID NO:4, ose shtami bakterial ka sekuencën 16s rARN të përfaqësuar nga SEQ ID NO:4.

8. Përbërja për përdorimin e secilit prej pretendimeve, ku përbërja është për administrim oral; dhe/ose ku përbërja përmban një ose më shumë mbushësa ose transportuesa farmaceutikisht të pranueshëm; dhe/ose ku shtami bakterial është i liofilizuar.

9. Një produkt ushqimor ose përbërje vaksine që përmban përbërjen e secilit prej pretendimeve të mëparshme, për përdorimin e secilit prej pretendimeve të mëparshme.

10. Një qelizë e shtamit të *Blautia stercoris* e depozituar nën numrin hyrës NCIMB 42381; ose një përbërje që përmban qelizën e përmendur, opsionalisht ku përbërja përmban një transportues ose mbushës farmaceutikisht të pranueshëm.

11. Një kulturë e pastër biologjike e shtamit *Blautia stercoris* e depozituar nën numrin hyrës NCIMB 42381.

12. Një qelizë e shtamit të *Blautia stercoris* e depozituar nën numrin hyrës NCIMB 42381, për tu përdorur në terapi.

13. Një qelizë e shtamit të *Blautia wexlerae* e depozituar nën numrin hyrës NCIMB 42486; ose një përbërje që përmban qelizën e përmendur, opsionalisht ku përbërja përmban një transportues ose mbushës farmaceutikisht të pranueshëm.

14. Një kulturë e pastër biologjike e shtamit të *Blautia wexlerae* e depozituar nën numrin hyrës NCIMB 42486.

15. Një qelizë e shtamit të *Blautia wexlerae* e depozituar nën numrin hyrës NCIMB 42486, për tu përdorur në terapi, opsionalisht ku qeliza është për tu përdorur në një metodë të përcaktuar në secilin prej pretendimeve 1-5.

(11) **8697**

(97) EP2432472 / 02/10/2019

(96) 10721227.6 / 21/05/2010

(22) 21/10/2019

(21) AL/P/ 2019/741

(54) **3-[4-(7H-PIRROLO[2,3-D]PYRIMIDIN-4-IL)-1H-PIRAZOL-1-IL]OKTAN- OSE HEPTAN-NITRIL SI FRENUESA TË JAK (Janus kinasës)**

17/12/2019

(30) 180582 P 22/05/2009 US

(71) Incyte Holdings Corporation

1801 Augustine Cut-Off, Wilmington, DE 19803, US

(72) RODGERS, James D. (2 Hillside Lane, Landenberg, Pennsylvania 19350) ;LI, Yun-Long (1 Pin Oak Drive, Chadds Ford, Pennsylvania 19317)

(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania LTD , Rr. A.Z. Çajupi, P.20/4, Ap.7/5, Tirane, 100

(57)

1. Një komponim, i cili është përzgjedhur nga

3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]oktannitril; dhe

3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]heptannitril;

ose një kripë e tij farmaceutikisht e pranueshme.

2. Komponimi i pretendimit 1, i cili është:

(a) 3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]otannitril, ose një kripë e tij farmaceutikisht e pranueshme;

(b) (3R)-3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-ol]oktannitril, ose një kripë e tij farmaceutikisht e pranueshme;

(c) (3S)-3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]oktannitril, ose një kripë e tij farmaceutikisht e pranueshme;

(d) 3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]oktannitril kripë e acidit fosforik;

(e) (3R)-3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]oktannitril kripë e acidit fosforik;

(f) (3S)-3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]oktannitril kripë e acidit fosforik;

- (g) 3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]heptannitril, ose një kripë e tij farmaceutikisht e pranueshme;
- (h) (3R)-3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]heptannitril, ose një kripë e tij farmaceutikisht e pranueshme;
- (i) (3S)-3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]heptannitril, ose një kripë e tij farmaceutikisht e pranueshme;
- (j) 3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]heptannitril kripë e acidit fosforik;
- (k) (3R)-3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]heptannitril kripë e acidit fosforik; ose
- (l) (3S)-3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]heptannitril kripë e acidit fosforik.

3. Një përbërje që përmban komponimin ose kripën e pretendimit 1 ose të pretendimit 2, dhe të paktën një transportues farmaceutikisht i pranueshëm.

4. Përbërja e pretendimit 3 e cila është e përshtatshme për

- (a) administrim lokal; ose
- (b) për administrim transdermal.

5. Përbërja e pretendimit 4 (b) e cila është në formën e një bandazhi, pomade, locioni, kremi, ose xheli transdermal.

6. Komponimi ose kripa e pretendimit 1 ose e pretendimit 2 për tu përdorur në trajtimin e një sëmundjeje tek një pacient, ku sëmundja e përmendur shoqërohet me veprimtari JAK.

7. Komponimi ose kripa e pretendimit 1 ose e pretendimit 2 për tu përdorur në trajtimin e

- (a) një sëmundjeje autoimune;
- (b) kancerit;
- (c) një çrregullimi mieloproliferativ;
- (d) një sëmundjeje inflamatore;
- (e) një sëmundjeje virale;
- (f) një refuzimi të transplantit të organeve;
- (g) dëmtimit të reperfuzionit të ishemiës ose të një sëmundjeje të lidhur me një ngjarje ishemike inflamatore;
- (h) anoreksisë ose kakekisë;
- (i) lodhjes;
- (j) refuzimit të alograftit ose të sëmundjes graft versus host;
- (k) artritis reumatoid;
- (l) psoriazisit;
- (m) dermatitis;
- (n) iritisit;
- (o) uveitis;
- (p) skleritis; ose
- (q) konjuktivitit.

8. Komponimi për tu përdorur sipas pretendimit 7(a) ku sëmundja autoimune e përmendur është:

- (a) një çrregullim i lëkurës, sklerozë e shumëfishtë, artritis reumatoid, artritis psoriatik, artritis juvenil, diabet i tipit I, lupus, psoriazis, sëmundja e zorrës inflamatore, sëmundja Crohn, miastenia gravis, nefropatitë e imunoglobulinës, miokarditi, ose çrregullimi autoimun i tiroides;
- (b) një çrregullim bulloz i lëkurës;

- (c) artrit reumatoid; ose
- (d) një çrregullim i lëkurës.

9. Komponimi për tu përdorur sipas pretendimit 8(b) ku çrregullimi bulloz i lëkurës është pemphigus vulgaris (PV) ose pemphigoid bullous (BP).

10. Komponimi për tu përdorur sipas pretendimit 8(d) ku çrregullimi i lëkurës i përmendur është

- (a) dermatit atopik ose psoriazis; ose
- (b) ndjeshmëria e lëkurës, irritimi i lëkurës, shpërthim puçrash në lëkurë, dermatiti i kontaktit ose ndjeshmëria e kontaktit alergjik.

11. Komponimi për tu përdorur sipas pretendimit 7(b) ku kanceri i përmendur është

- (a) një tumor solid;
- (b) kancer i prostatës, kancer i veshkës, kancer hepatic, kancer i gjirit, kancer i mushkërisë, kancer i tiroides, sarkoma Kaposi, sëmundja Castleman ose kancer pankreatik;
- (c) limfomë, leuçemi, ose mielomë e shumëfishtë; ose
- (d) limfomë e qelizave-T të lëkurës ose limfomë e qelizave-B të lëkurës.

12. Komponimi për tu përdorur sipas pretendimit 7(c) ku çrregullimi mieloproliferativ i përmendur është policitemia vera (PV), trombocitopenia thelbësore (ET), mielofibroza parësore (PMF), leuçemia mielogjenoze kronike (CML), leuçemia mielomonocitike kronike (CMML), sindroma hipereozonofilike (HES), mielofibroza idiopatike (IMF), ose sëmundja e qelizave mastoide sistemike (SMCD).

13. Komponimi për tu përdorur sipas pretendimit 7(d) ku sëmundja inflamatore e përmendur është iritis, uveit, sklerit, konjuktivit, sëmundje inflamatore e traktit respirator, miopati inflamatore, ose miokardit.

14. Komponimi për tu përdorur sipas pretendimit 7(e) ku sëmundja virale e përmendur është Virusi Epstein Barr (EBV), Hepatiti B, Hepatiti C, HIV, HTLV 1, Virusi Varicel-Zoster (VZV) ose Virusi Papiloma Njerëzor (HPV).

15. Një proces për të përgatitur një kripë të acidit fosforik të një komponimi të Formulës III:

ku R1 është H ose metil, që përmban kombinimin e një komponimi të Formulës III me acid fosforik.

16. Procesi i pretendimit 15 ku procesi i përmendur është një proces për të përgatitur:

- (a) 3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]oktannitril kripë e acidit fosforik; ose
- (b) 3-[4-(7H-pirrolo[2,3-d]pirimidin-4-il)-1H-pirazol-1-il]heptannitril kripë e acidit fosforik.

17. Procesi i pretendimit 15 ose i pretendimit 16 ku kombinimi i përmendur kryhet në praninë e një tretësi organik.

18. Procesi i pretendimit 17 ku tretësi organik është një alkool.

19. Procesi i pretendimit 18 ku alkooli është përzgjedhur nga grupi që konsiston në metanol, etanol, isopropanol, dhe butanol.

20. Procesi i pretendimit 15 ose i pretendimit 16 ku kombinimi kryhet në një temperaturë

- (a) më të madhe se afërsisht 20 °C; ose
- (b) 60 °C.

(11) **8729**

(97) EP3261720 / 18/09/2019

(96) 16706741.2 / 18/02/2016

(22) 22/10/2019

(21) AL/P/ 2019/742

(54) **ANTITRUPA PËR TAU DHE PËRDORIMET E TYRE**

17/12/2019

(30) 201562121116 P 26/02/2015 US

(71) Eli Lilly and Company

Lilly Corporate Center, Indianapolis, IN 46285, US

(72) LU, Jirong (c/o Eli Lilly and Company P.O. Box 6288, Indianapolis, Indiana 46206-6288);

ALVARADO, Alberto (c/o Eli Lilly and Company P.O. Box 6288, Indianapolis, Indiana 46206-6288);

DRIVER, David (c/o Eli Lilly and Company P.O. Box 6288, Indianapolis, Indiana 46206-6288)

;HAYASHI, Mansuo Lu (c/o Eli Lilly and Company P.O. Box 6288, Indianapolis, Indiana 46206-6288)

(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania LTD , Rr. A.Z. Çajupi, Pall. 20/4, Ap.15, Tiranë, 100

(57)

1. Një antitруп monoklonal që lidh tau njerëzor që përmban një zonë të ndryshueshme zinxhiri të lehtë (LCVR) dhe një zonë të ndryshueshme zinxhiri të rëndë (HCVR), ku sekuenca aminoacide e LCVR-së jepet nga SEQ ID NO:9 dhe sekuenca aminoacide e HCVR-së jepet nga SEQ ID NO:10.

2. Antitрупi monoklonal i pretendimit 1, që përmban një zinxhir të lehtë (LC) dhe një zinxhir të rëndë (HC), ku sekuenca aminoacide e LC-së jepet nga SEQ ID NO: 1 dhe sekuenca aminoacide e HC-së jepet nga SEQ ID NO: 2.

3. Një molekulë ADN-je që përmban një sekuençë polinukleotide që kodon një polipeptid që ka sekuençën aminoacide të SEQ ID NO:1, dhe që përmban një sekuençë polinukleotide që kodon një polipeptid që ka sekuençën aminoacide të SEQ ID NO:2.

4. Një molekulë ADN-je sipas pretendimit 3 ku sekuenca polinukleotide që kodon një polipeptid që ka sekuençën aminoacide të SEQ ID NO:1 jepet nga SEQ ID NO:11 dhe sekuenca polinukleotide që kodon një polipeptid që ka sekuençën aminoacide të SEQ ID NO:2 jepet nga SEQ ID NO:12.

5. Një qelizë gjitari që përmban molekulën e ADN-së të pretendimit 3 ose të pretendimit 4, ku qeliza është e aftë të shprehë një antitруп monoklonal që përmban një zinxhir të lehtë që ka një sekuençë aminoacide të SEQ ID NO:1 dhe një zinxhir të rëndë që ka një sekuençë aminoacide të SEQ ID NO:2.

6. Një proces për të prodhuar një antitруп monoklonal që përmban një zinxhir të lehtë që ka një sekuençë aminoacide të SEQ ID NO:1 dhe një zinxhir të rëndë që ka një sekuençë aminoacide të SEQ ID NO:2, ku procesi përmban mbjelljen e qelizës gjitare të pretendimit 5 në kushte të tilla që të shprehet antitрупi monoklonal, dhe të përftohet antitрупi monoklonal i shprehur.

7. Një përbërje farmaceutike që përmban një antitруп monoklonal të secilit prej pretendimeve 1 ose 2 dhe një ose më shumë transportues, tretës ose mbushës farmaceutikisht të pranueshëm.

8. Një antitруп monoklonali pretendimit 1 ose i pretendimit 2 për tu përdorur në terapi.
9. Një antitруп monoklonal i pretendimit 1 ose i pretendimit 2 për tu përdorur në trajtimin e një sëmundjeje të përzgjedhur nga sëmundja Alzheimer, Paraliza Mbinukleare Progresive dhe sëmundja Pick.

(11) **8732**

(97) EP3347579 / 25/09/2019

(96) 16750823.3 / 10/08/2016

(22) 22/10/2019

(21) AL/P/ 2019/743

(54) **SISTEM SHKARKIMI PËR NJË MOTOR VETËLËVIZËS ME DJEGIE TË BRENDSHME**
17/12/2019

(30) 15002654 10/09/2015 EP

(71) Akrapovic d.d.

Malo Hudo 8a, 1295 Ivancna Gorica, SI

(72) AKRAPOVIC, Igor (Rozna dolina Cesta VIII 10/A, 1000 Ljubljana); KLEMENC, Jaka (Skrabceva 21, 1000 Ljubljana); SEDEJ, Gasper (Jelicni Vrh 7, 5280 Idrija); VIPAVEC, Simon (Gubceva 7, 8340 Crnomelj)

(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania LTD, Rr. A.Z. Çajupi, Pall. 20/4, Ap.15, Tiranë, 100

(57)

1. Sistem shkarkimi (1) për një motor vetëlëvizës me djegie të brendshme (3), i tillë si një motor V ose motor boxer, që përmban:

një gyp shkarkimi të majtë (5) të bashkueshëm tek një grup cilindrash të majtë (35) të motorit vetëlëvizës me djegie të brendshme (3); dhe

një gyp shkarkimi të djathtë (7) të bashkueshëm tek një grup cilindrash të djathtë (37) të motorit vetëlëvizës me djegie të brendshme (3);

secili gyp shkarkimi (5, 7) përmban një strukturë gypash që përcakton

- një hyrje në gyp (51, 71) për të pritur gazin e shkarkuar të nxjerrë nga një grup cilindrash tek të cilët është i bashkueshëm gypit i shkarkimit (5, 7),

- të paktën një dalje shkarkimi (53, 73) me dalje në atmosferë, dhe

- një tub bashkues (55, 75) që zgjatet ndërmjet hyrjes së gypit dhe daljes së shkarkimit (53, 73), duke përfshirë një hapësirë hyrëse (55i, 75i) për të pritur gazin e shkarkuar nga hyrja në gyp (51, 71) dhe një hapësirë dalëse (55o, 75o) për të transferuar gazin e shkarkuar në drejtim të daljes së shkarkimit (53, 73);

karakterizuar në atë që

tubi bashkues i majtë (55) dhe tubi bashkues i djathtë (75) bashkohen për të realizuar një bashkim tubash (9) të tillë që tubat bashkues formojnë një hapje bashkuese të përbashkët (91) për të transferuar gazin e shkarkuar ndërmjet gypave (5, 7);

dhe në atë që sistemi shkarkues (1) përmban të paktën një anëtar valvul (93, 93b, 95, 97) për të hapur dhe/ose për të mbyllur hapjen bashkuese të përbashkët (91),

dhe në atë që sistemi i shkarkimit (1) përfshin një pajisje valvul (13, 52, 72) për të frenuar pjesërisht dhe/ose tërësisht shtegun rrjedhës të gazit të shkarkuar brenda gypit shkarkues të majtë (5) dhe/ose brenda gypit shkarkues të djathtë (7) në një hapje përkatëse të gypit shkarkues ndërmjet hapësirës hyrëse (55i,

75i) dhe të paktën një hapësirë dalëse (55o, 75o), dhe nëpërmjet një njësie kontrolli (11) të përshtatur për të kontrolluar anëtarin valvul (93, 93b, 95, 97) si dhe pajisjen valvul (13, 52, 72) sipas të paktën njërit prej cilësimeve të mëposhtme:

- a) hapja bashkuese e përbashkët (91) e mbyllur dhe hapësira e gypit shkarkues të djathtë dhe të majtë e hapur; dhe/ose
- b) hapja bashkuese e përbashkët (91) e hapur dhe hapësira e gypit shkarkues të djathtë dhe të majtë e hapur;

dhe në atë që njësia e kontrollit (11) është përshtatur për të kontrolluar anëtarin valvul (93, 93b, 95, 97) si dhe pajisjen valvul (13) sipas të paktën njërit prej cilësimeve të mëposhtme:

- c) hapja bashkuese e përbashkët (91) e hapur dhe hapësira e gypit shkarkues të djathtë dhe/ose të majtë pjesërisht e mbyllur dhe/ose
- d) hapja bashkuese e përbashkët (91) e hapur dhe njëra hapësirë e gypit shkarkues e hapur, hapësira e gypit shkarkues tjetër e mbyllur tërësisht.

2. Sistem shkarkimi (1) sipas pretendimit 1, karakterizuar në atë që tubat bashkues (55, 75) janë përkulur, veçanërisht në formë këndore dhe/ose të harkuara, preferueshëm në mënyrë të tillë që bashkimi i tubave (9) është kryesisht me formë-X dhe/ose në atë që bashkimi i tubit (9) realizon lidhjen e vetme për transferimin e gazit të shkarkuar ndërmjet gypave të shkarkimit (5, 7), dhe/ose në atë që hapja bashkuese e përbashkët (91) përcakton një zonë të përzier e cila është ndërmjet 0.25 dhe 4.0 herë më e madhe se, preferueshëm ndërmjet 0.75 dhe 1.5 herë më e madhe se, veçanërisht me të njëjtën madhësi me, një zonë reference të përcaktuar nga zona e ndërprerjes planore të gypit shkarkues të majtë dhe/ose të djathtë (5, 7), preferueshëm tubi(at) shkarkues (55, 75) të tyre.

3. Sistemi i shkarkimit (1) sipas njërit prej pretendimeve të mëparshme, karakterizuar në atë që të paktën një anëtar valvul i përmendur (93) përfshin një anëtar mbyllës, i tillë si një llapë, për të mbuluar të paktën 50%, preferueshëm të paktën 75%, veçanërisht të paktën 90%, ose tërësinë e zonës së përzier të përcaktuar nga hapja bashkuese e përbashkët (91), ku veçanërisht anëtari mbyllës (91) përmban një hapësirë anashkalimi, ku veçanërisht anëtari mbyllës mund të rrotullohet, posaçërisht për 90°, për të kaluar ndërmjet një gjendjeje plotësisht të hapur dhe të mbyllur.

4. Sistem shkarkimi (1) sipas njërit prej pretendimeve të mëparshme, karakterizuar në atë që secili gyp shkarkimi (5,7) për më tej përmban një tub anashkalimi (57, 77) që të drejton tek një dalje shkarkimi dytësore (53b, 73b) që ka dalje në atmosferë, ku veçanërisht tubi i anashkalimit (57, 77) degëzohet në pjesën e sipërme nga pajisja valvul (13) dhe veçanërisht në pjesën e sipërme nga bashkimi i tubave (9).

5. Sistem shkarkimi (1) sipas njërit prej pretendimeve të mëparshme, karakterizuar në atë që pajisja valvul (13) është përfshirë në bashkimin e tubave (9), ku bashkimi për-fshin një anëtar valvul të parë dhe një anëtar valvul të dytë, ku veçanërisht anëtarët valvul të parë dhe të dytë janë të lëvizshëm në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

6. Sistem shkarkimi sipas pretendimit 5, karakterizuar në atë që anëtari valvul i parë është një anëtar valvul i majtë (95) i lëvizshëm për të hapur në mënyrë përzgjedhëse hapjen bashkuese të përbashkët (91) dhe/ose hapësirën e gypit shkarkues të majtë dhe në atë që anëtari valvul i dytë është një anëtar valvul i drejtë (97) i lëvizshëm për të hapur në mënyrë përzgjedhëse hapësirën bashkuese të përbashkët (91) dhe/ose hapësirën e gypit shkarkues të djathtë.

7. Sistem shkarkimi sipas pretendimit 5, karakterizuar në atë që anëtari valvul i parë realizohet nga një anëtar valvul qendror (93b) për të hapur ose mbyllur në mënyrë për-zgjedhëse hapësirën bashkuese të përbashkët (91) dhe në atë që anëtari valvul i dytë realizohet nga një anëtar valvul i përbashkët (13b) për të hapur ose mbyllur të dyja hapësirat e gypave.

8. Sistem shkarkimi (1) sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, që përmban:

të paktën dy gypa shkarkues (53, 53a, 53b, 73, 73a, 73b), veçanërisht një gyp shkarkimi kryesor (53a, 73a) dhe një gyp shkarkimi me anashkalim (53b, 73b), me dalje në atmosferë;

karakterizuar në atë që secili gyp shkarkimi (5, 7) për më tej përmban

-pajisjen valvul (13, 52, 72) për të hapur dhe/ose mbyllur një hapësirë gypi të sistemuar ndërmjet hyrjes në gyp (51, 71) dhe njërit nga të paktën dy gypat shkarkues (53, 73), në mënyrë të tillë që, në gjendjen e hapur të pajisjes valvul (13, 52, 72), gazi i shkarkuar është i transferueshëm nga hyrja në gyp (51, 71) tek të paktën dy gypat shkarkues (53a, 53b, 73a, 73b), dhe në mënyrë të tillë që, në gjendjen e mbyllur të pajisjes valvul (13, 52, 72), gazi i shkarkuar ndalohet për të rrjedhur nga hyrja në gyp (51, 71) tek preferueshëm saktësisht njëri prej të paktën dy gypave shkarkues, veçanërisht gypi shkarkues kryesor (53a, 73a).

9. Sistem shkarkimi (1) sipas pretendimit 8, karakterizuar në atë që zona e ndarjes planore e gypave shkarkues kryesore (53a, 73a) është më e madhe se, preferueshëm afërsisht 1.1, 1.25, 1.3, 1.5, 2.0, 2.5, 3.0, 4.0 ose më shumë herë e madhe sa, zona e ndarjes planore të gypave shkarkues të anashkaluar (53a, 73a).

10. Sistem shkarkimi (1) sipas njërit prej pretendimeve 8 ose 9, karakterizuar në atë që secili gyp shkarkimi (5, 7) për më tej përmban një linjë anashkalimi (57, 77) për të transferuar gazin e shkarkuar nga hyrja në gyp (51, 71) tek njëri prej të paktën dy hapje shkarkuese (53, 53a, 53b, 73, 73a, 73b), preferueshëm tek hapja shkarkuese me anashkalim (53b, 73b), dhe/ose në atë që linja e anashkalimit (57, 77) është ndarë nga tubacioni kryesor i gypit shkarkues përkatës (5, 7), ku tubacioni kryesor përfshin hyrjen në gyp përkatës (51, 71) dhe të paktën një tjetër nga të paktën dy hapjet shkarkuese (53, 53a, 53b, 73, 73a, 73b), preferueshëm hapja shkarkuese kryesore (53a, 73a) e një tubi bashkues (55, 75) të gypit shkarkues përkatës (5, 7) me tubin bashkues (55, 75) përfshin hapjen bashkuese (91).

11. Sistem shkarkimi (1) sipas njërit prej pretendimeve të mëparshme, karakterizuar në atë që sistemi i shkarkimit (1) përfshin një njësi kontrolli (11) për të kontrolluar anëtarin valvul (93) për të hapur ose mbyllur hapjen bashkuese të përbashkët (91) që është në varësi të një gjendjeje funksionimi të motorit, e tillë si një shkallë rpm e paracaktuar, për shembull më pak se 3000 rpm ose më shumë se 3000 rpm, dhe/ose në varësi të një cilësimi manual.

12. Sistem shkarkimi (1) sipas njërit prej pretendimeve të mëparshme, karakterizuar në atë që njësia e kontrollit (1) është përshtatur për të kontrolluar anëtarin valvul (93, 93b, 95, 97) si dhe pajisjen valvul (13, 52, 72) në vazhdim sipas cilësimit si vijon:

e. hapja e bashkimit të përbashkët (91) e mbyllur dhe hapja e gypit shkarkues të djathtë dhe të majtë tërësisht e mbyllur.

(11) **8769**

(97) EP2739740 / 02/10/2019

(96) 12746246.3 / 03/08/2012

(22) 22/10/2019

(21) AL/P/ 2019/746

(54) **MINJ ME VARG TË LEHTË UNIVERSAL TË HUMANIZUAR**

26/12/2019

(30) 201161515374 P 05/08/2011 US

(71) Regeneron Pharmaceuticals, Inc.

777 Old Saw Mill River Road, Tarrytown, NY 10591, US

(72) MACDONALD, Lynn (16 Gedney Way, White Plains, NY 10591); STEVENS, Sean (355 Berry Street 413, San Francisco, CA 94158); MURPHY, Andrew, J. (10 Newton Court, Croton-on-hudson, NY 10520); MCWHIRTER, John (2035 Crescent Drive, Tarrytown, NY 10591); DAVIS, Samuel (332 West 88th Street Apt. B2, New York, NY 10024); BUCKLER, David, R. (6 Erick Court, Chester, NJ 07930); HOSIAWA, Karolina, A. (14 Church Street, 2nd Floor, Tarrytown, NY 10591)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(57)

1. Një mi, gjenomi i të cilit përmban:

(a) një lokus të ndryshueshëm të vargut të rëndë të imunoglobulinës së humanizuar që përfshin të paktën një segment VH human të paorganizuar, të paktën një segment DH human të paorganizuar dhe të paktën një segment JH human të paorganizuar, të lidhur në mënyrë funksionale me një gjen të regjionit të pandryshueshëm të vargut të rëndë endogjen;

(b) një lokus të ndryshueshëm të vargut të lehtë të imunoglobulinës së humanizuar, që përfshin jo më shumë se një, ose jo më shumë se dy, sekuenca V/J të vargut të lehtë human të riorganizuar, të lidhura në mënyrë funksionale me një gjen të regjionit të pandryshueshëm të vargut të lehtë endogjen; dhe,

(c) një sekuenca ektopike të acidit nukleik që shpreh një proteinë ADAM6a funksionale të miut, ose një ortolog funksional ose homolog funksional, ose një fragment funksional të saj dhe një sekuenca ektopike të acidit nukleik që shpreh një proteinë ADAM6b funksionale të miut, ose një ortolog funksional ose homolog funksional, ose një fragment funksional të saj, ku proteinat ADAM6, ortologët, homologët ose fragmentet janë funksionale te një mi mashkull, dhe ku funksioni në fjalë është i lidhur me fertilitetin mashkullor,

ku miu në fjalë ka funksion të reduktuar ose të eliminuar të ADAM6 endogjene dhe karakterizohet më tej nga mungesa në gjenomin e tij të një segmenti të gjenit V κ të imunoglobulinës endogjene të paorganizuar dhe të një segmenti të gjenit J κ të imunoglobulinës endogjene të paorganizuar.

2. Miu sipas pretendimit 1, ku sekuenat ektopike të acidit nukleik janë në një lokus të ndryshëm nga lokusi i ndryshueshëm i vargut të rëndë të imunoglobulinës.

3. Një mi, gjenomi i të cilit përmban:

një lokus të ndryshueshëm të vargut të rëndë të imunoglobulinës së humanizuar që përfshin të paktën një segment VH human të paorganizuar, të paktën një segment DH human të paorganizuar dhe të paktën një segment JH human të paorganizuar, të lidhur në mënyrë funksionale me një gjen të regjionit të pandryshueshëm të vargut të rëndë endogjen;

një lokus të ndryshueshëm të vargut të lehtë të imunoglobulinës së humanizuar që përfshin një sekuenca të vetme V/J të vargut të lehtë human të riorganizuar, të lidhur në mënyrë funksionale me një gjen të regjionit të pandryshueshëm të vargut të lehtë endogjen,

ku miu shpreh një varg të lehtë të vetëm kimerik, dhe ku miu, nga sekuenat ektopike të acidit nukleik, shpreh një proteinë ADAM6a funksionale të miut dhe një proteinë ADAM6b funksionale të miut, ku proteinat ADAM6a dhe ADAM6b janë funksionale te një mi mashkull, dhe ku funksioni në fjalë është i lidhur me fertilitetin mashkullor,

ku miu në fjalë ka funksion të reduktuar ose të eliminuar të ADAM6 endogjene dhe karakterizohet më tej nga mungesa në gjenomin e tij të një segmenti të gjenit V κ të imunoglobulinës endogjene të paorganizuar dhe të një segmenti të gjenit J κ të imunoglobulinës endogjene të paorganizuar.

4. Miu i pretendimit 3, ku sekuenat ektopike të acidit nukleik janë në një pozicion që nuk është brenda një lokusi të vargut të rëndë të imunoglobulinës endogjene.

5. Një qelizë miu, gjenomi i të cilës përmban:

